

Porsche Albania Sh.p.k.

**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më
31 dhjetor 2013**

(dhe raporti i audituesve të pavarur)



KPMG Albania Sh.p.k
"Dëshmorët e Kombit" Blvd
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524
+355(4)2274 534
Telefax +355(4)2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raporti i audituesve të pavarur

Pronarit të
Porsche Albania Sh.p.k.

Tiranë, 30 janar 2014

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Porsche Albania Sh.p.k ("Shoqëria"), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar në 31 dhjetor 2013, pasqyrat e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse, ndryshimeve në kapital dhe flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve


Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2013, të rezultatit të saj financiar dhe të flukseve të saj monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.



Steven Nutley
Partner

KPMG Albania Sh.p.k.
“Deshmoret e Kombit” Blvd.
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Porsche Albania Sh.p.k.



Pasqyra e pozicionit financiar (vlerat në Lek)

	Shënime	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Aktive:			
Aktiveve afatgjata:			
Aktive afatgjata jo-materiale	6	142,147,703	168,081,063
Aktive afatgjata materiale	7	705,700,197	785,381,229
		847,847,900	953,462,292
Aktiveve afatshkurtra:			
Inventari	8	356,146,568	282,730,631
Tatim fitimi i parapaguar	23	2,432,643	2,449,015
Llogari të arkëtueshme	9	48,778,583	88,734,336
Aktive të tjera	10	2,152,970	5,135,319
Mjete monetare dhe ekuivalente	11	57,417,692	121,701,958
		466,928,456	500,751,259
Totali i aktiveve		1,314,776,356	1,454,213,551
Kapitali:			
Kapitali aksioner	12	707,911,000	707,911,000
Fitime/(humbje) të mbartura		15,606,679	(13,096,836)
Fitimi i vitit		32,435,983	28,703,515
		755,953,662	723,517,679
Detyrime afatshkurtra:			
Kredi të marra	13	448,932,199	493,592,127
Provizione	14	2,612,213	18,465,031
Llogari të pagueshme	15	83,032,362	173,249,212
Detyrime të tjera	16	24,245,920	45,389,502
		558,822,694	730,695,872
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		1,314,776,356	1,454,213,551

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese dhe pjesët përbërëse të pasqyrave financiare në faqet 8 deri 28.

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga Drejtorët e Përgjithshëm të Porsche Albania Sh.p.k. më 30 Janar 2014.

Fabian Jungnitsch
Drejtor i Përgjithshëm



Gentian Bushati
Drejtor i Përgjithshëm



Porsche Albania Sh.p.k.

Pasqyra e fitim ose humbje dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor
(vlerat në Lek)

	Shënime	2013	2012
Shitjet	17	1,414,633,283	1,502,737,101
Kosto e shitjeve	18	(1,130,890,303)	(1,203,656,834)
Fitimi bruto		283,742,980	299,080,267
Shpenzime personeli	19	(97,887,086)	(92,162,517)
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale	6,7	(52,839,468)	(53,285,480)
Furnizime dhe shërbime	20	(93,945,081)	(103,647,283)
Të ardhura/(shpenzime) të tjera, neto	21	13,702,237	(3,454,241)
Fitimi operativ		52,773,582	46,530,746
Shpenzime financiare		(14,144,731)	(12,141,470)
Të ardhura financiare		257,200	747,936
Shpenzime financiare neto	22	(13,887,531)	(11,393,534)
Fitimi para tatimit		38,886,051	35,137,212
Tatimi mbi fitimin	23	(6,450,068)	(6,433,697)
Fitimi neto për vitin		32,435,983	28,703,515
Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto nga tatimi mbi fitimin		-	-
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin		32,435,983	28,703,515

Pasqyra e fitim ose humbje dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese dhe pjesë përbërëse të pasqyrave financiare në faqet 8 deri 28.

Porsche Albania Sh.p.k.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital
(vlerat në Lek)

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

	Kapitali aksioner	(Humbje)/Fitim i mbartur	Totali
Gjendja më 1 janar 2012	707,911,000	(13,096,836)	694,814,164
Fitimi i vitit	-	28,703,515	28,703,515
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin	-	28,703,515	28,703,515
Totali i transaksioneve me pronarët e Shoqërisë	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2012	707,911,000	15,606,679	723,517,679

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

	Kapitali aksioner	Fitim i mbartur	Totali
Gjendja më 1 janar 2013	707,911,000	15,606,679	723,517,679
Fitimi i vitit	-	32,435,983	32,435,983
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin	-	32,435,983	32,435,983
Totali i transaksioneve me pronarët e Shoqërisë	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2013	707,911,000	48,042,662	755,953,662

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese dhe pjesë përbërëse të pasqyrave financiare në faqet 8 deri 28.

Porsche Albania Sh.p.k.

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor
(vlerat në Lek)

	Shënime	2013	2012
Flukse monetare nga veprimtari operative			
Fitimi neto për vitin		32,435,983	28,703,515
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale	6;7	52,839,468	53,285,480
(Fitimi)/humbja nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	21	(805,695)	52,534
Rënia në vlerë/(rimarrja) e inventarit në vlerën neto të realizueshme	18	1,212,595	(6,364,407)
Të ardhura nga interesi	22	(18,107)	(106,973)
Shpenzime interesi	22	8,022,027	7,699,339
Tatimi mbi fitimin	23	6,450,068	6,433,697
Fitimi operativ përpara ndryshimeve në kapitalin punues		100,136,339	89,703,185
Ndryshime në llogaritë e arkëtueshme		39,955,753	(43,948,442)
Ndryshime në aktive të tjera		2,982,349	1,152,283
Ndryshime në inventar		(22,944,124)	58,156,488
Ndryshime në llogaritë e pagueshme		(90,216,850)	(124,950,699)
Ndryshime në provizione		(15,852,818)	(6,040,093)
Ndryshime në detyrime të tjera		(21,143,582)	(12,460,515)
Mjete monetare përdorur në veprimtaritë operative		(7,082,933)	(38,387,793)
Tatim fitim i paguar		(6,433,696)	(9,885,068)
Interes i paguar		(5,384,369)	(4,881,765)
Interes i arkëtuar		18,107	106,973
Mjete monetare neto përdorur në veprimtaritë operative		(18,882,891)	(53,047,653)
Flukse monetare nga veprimtaritë investuese			
Arkëtime nga shitja e mjeteve të transportit		10,592,914	4,072,854
Blerje të aktiveve afatgjata materiale	7	(7,544,796)	(25,256,210)
Blerje të aktiveve afatgjata jo-materiale	6	(1,151,907)	(173,393,384)
Mjetet monetare neto nga/(përdorur në) veprimtaritë investuese		1,896,211	(194,576,740)
Flukse monetare nga veprimtaritë financuese			
(Shlyerje)/ arkëtime neto nga kreditë		(47,297,586)	321,499,388
Mjete monetare neto (përdorur në) /nga veprimtaritë financuese		(47,297,586)	321,499,388

Porsche Albania Sh.p.k.

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor (vazhdim)
(vlerat në Lek)

	Shënime	2013	2012
(Pakësimi)/ rritja neto e mjeteve monetare		(64,284,266)	73,874,995
Mjete monetare në 1 janar	11	<u>121,701,958</u>	<u>47,826,963</u>
Mjete monetare në 31 dhjetor	11	<u>57,417,692</u>	<u>121,701,958</u>

Pasqyra e flukseve monetare duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese dhe pjesë përbërëse të pasqyrave financiare në faqet 8 deri 28.

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

1	Informacion i përgjithshëm	8	7	Aktive afatgjata materiale	20
2	Bazat e përgatitjes	8	8	Inventari	22
(a)	Deklarata e përputhshmërisë.....	8	9	Llogari të arkëtueshme	22
(b)	Baza e matjes	8	10	Aktive të tjera	22
(c)	Monedha funksionale dhe raportuese	8	11	Mjete monetare dhe ekuivalente	22
(d)	Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve.....	8	12	Kapitali aksioner	22
3	Politika të rëndësishme kontabël	9	13	Kredi të marra	23
(a)	Aktive afatgjata materiale	9	14	Provizione	23
(b)	Aktive afatgjata jo-materiale	9	15	Llogari të pagueshme	23
(c)	Inventarët	10	16	Detyrime të tjera	23
(d)	Instrumentat financiarë	10	17	Shitjet	24
(e)	Zhvlerësimi	11	18	Kosto e shitjeve	24
(f)	Njohja e të ardhurave	12	19	Shpenzime personeli	24
(g)	Qeraja operative.....	12	20	Furnizime dhe shërbime	25
(h)	Përfitimet e punonjësve	12	21	Të ardhura/(shpenzime) të tjera, neto	25
(i)	Provizionet.....	12	22	Të ardhura dhe shpenzime financiare	25
(j)	Të ardhura dhe shpenzime financiare	13	23	Tatimi mbi fitimin	26
(k)	Transaksionet në monedhë të huaj.....	13	24	Palët e lidhura	26
(l)	Tatim fitimi.....	13	25	Detyrime të kushtëzuara dhe angazhime 28	
(m)	Standarde dhe interpretime të reja ende të pa-zbatuara	14	26	Ngjarje pas datës së raportimit	28
4	Përcaktimi i vlerave të drejta	14			
5	Administrimi i riskut financiar	14			
(i)	Risku i kredisë	15			
(ii)	Risku i likuiditetit	15			
(iii)	Risku i tregut	17			
(iv)	Menaxhimi i kapitalit.....	18			
(v)	Vlera e drejtë kundrejt vlerës kontabile	18			
6	Aktive afatgjata jo-materiale	19			

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(vlerat në Lek, përvecse kur është shprehur ndryshe)

1 Informacion i përgjithshëm

Porsche Albania Sh.p.k. (“Shoqëria”) u themelua gjatë vitit 2005, e regjistruar dhe me vendndodhje kryesore të aktivitetit në Shqipëri, Autostrada Tirane – Durrës, Km. 3 Mëzez.

Është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në Gjykatën e Tiranës më 27 qershor 2005 me vendim gjykate nr. 33732.

Shoqëria filloi aktivitetin tregtar në gusht 2005 me kapital total të regjistruar prej 100,000 Lekë. Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është tregtia e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit.

Shoqëria zotërohet 100% nga Porsche Holding GmbH (“shoqëria mëmë”), e cila zotërohet plotësisht nga Volkswagen AG. Shoqëria mëmë është e regjistruar në Salzburg, Austri.

Më 31 dhjetor 2013 Shoqëria kishte 56 punonjës (2012: 56 punonjës).

2 Bazat e përgatitjes

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale për Shoqërinë.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

Në veçanti, informacione mbi elemente të rëndësishme të pasigurive në vlerësim dhe gjykimeve kritike në zbatimin e politikave kontabël, të cilat kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përfshirë në shënimet e mëposhtme.

- Shënimi 5 – Instrumentet Financiare (*Zhvlerësimi për llogaritë e arkëtueshme*)
- Shënimi 8 - Inventarët (*Shuma të parashikuara për humbje deri në vlerën neto të realizueshme*)
- Shënimi 14 - Provizione.

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(vlerat në Lek, përvecse kur është shprehur ndryshe)

3 Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

(a) Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shiko më poshtë) dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi (shih politikën kontabel 3(e)(ii)).

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimi ose humbja që vjen nga pakësimi i një zëri të aktiveve afatgjata materiale përcaktohet duke krahasuar shumën e arkëtuar nga pakësimi me vlerën kontabël të zërit, dhe njihet në baza neto në të ardhura/shpenzime të tjera operative në fitim ose humbje

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Shoqëri, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në fitim ose humbje me metodën lineare duke përdorur norma të cilat i përafrohen jetës mesatare ekonomike të dobishme. Toka nuk amortizohet.

Normat vjetore të amortizimit kanë qenë si më poshtë:

Ndërtesa	4%
Makineri dhe pajisje	10-20%
Pajisje elektronike	33%
Mobilje dhe pajisje zyre	20%
Mjete transporti	20%

(b) Aktive afatgjata jo-materiale

Aktivitet afatgjata jo-materiale të blera nga Shoqëria paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi (nëse ka). Amortizimi njihet në fitim ose humbje me metodën lineare mbi jetën e dobishme të aktivitet afatgjatë jo-material nga data që ai është i disponueshëm për përdorim. Normat vjetore të amortizimit kanë qenë si më poshtë:

Programe kompjuterike	33%
Të drejta mbi ekskluzivitetin e shitjes	15%

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(vlerat në Lek, përvecse kur është shprehur ndryshe)

3 Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(c) Inventarët

Inventarët janë vlerësuar me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e inventarëve llogaritet bazuar në metodën e identifikimit specifik dhe përfshin koston e blerjes, koston e shndërrimit dhe gjithë kostot e tjera për të sjellë inventarët në vendodhjen dhe në kushtet aktuale. Vlera neto e realizueshme është cmimi i vlerësuar i shitjes përgjatë aktivitetit normal të Shoqërisë, minus kostot e vlerësuara të shitjes.

(d) Instrumentat financiarë

Shoqëria zotëron vetëm instrumenta financiarë jo-derivativë.

(i) Aktive financiare jo-derivative

Aktive financiare jo-derivative përbëhen nga mjete monetare dhe ekuivalente me to, llogari të arkëtueshme. Shoqëria i klasifikon aktivet financiare jo-derivative në kategorinë “Hua dhe llogari të arkëtueshme”.

Shoqëria fillimisht njeh llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat në datën e krijimit. Aktivet financiare çregjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose nëse ajo i transferon të drejtat për të arkëtuar flukse nga aktivi financiar një pale tjetër, duke transferuar të gjitha risqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që përfitohet ose mbahet nga Shoqëria njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Aktivitet dhe detyrimet financiare prezantohen neto në pasqyrën pozicionit financiar, vetëm në rast se Shoqëria ka të drejtën ligjore dhe qëllimin për të shlyer ose arkëtuar detyrimin ose të drejtën neto.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme janë aktive financiare me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive. Këto aktive njihen fillimisht me vlerë të drejtë plus kosto direkte të transaksionit. Në vazhdim, llogaritë e arkëtueshme maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi (shih shënimin 3(e)(i)).

Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjete monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë paratë në arkë, depozitat rrjedhëse në banka dhe investime të tjera likuide afatshkurtra me maturitet original tre muaj ose më pak, për të cilat risku i një ndryshimi në vlerën e drejtë është i pakonsiderueshëm, dhe Shoqëria i përdor për manaxhimin e angazhimeve të saj afatshkurtra.

(ii) Detyrime financiare jo-derivative

Detyrimet financiare jo-derivative përfshijnë kreditë dhe llogaritë e pagueshme. Shoqëria i klasifikon detyrimet financiare jo-derivative në kategorinë “Detyrime të tjera financiare”.

Shoqëria fillimisht njeh llogaritë e pagueshme në datën e krijimit. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet e Shoqërisë të detajuara në kontratë përfundojnë, janë shlyer ose janë anuluar. Këto detyrime financiare njihen fillimisht me vlerë të drejtë plus kosto direkte të transaksionit. Në vazhdim, këto detyrime financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Kontabilizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare diskutohet në politikën kontabël 3(j).

(iii) Kapitali aksioner

Kapitali aksioner i Shoqërisë është njohur me vlerën nominale.

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(vlerat në Lek, përvecse kur është shprehur ndryshe)

3 Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(e) Zhvlerësimi

(i) Aktive financiare

Një aktiv financiar vlerësohet në fund të cdo periudhe raportuese për të përcaktuar nëse ka evidencë objektive që tregon se mund të jetë i zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse evidenca objektive tregon se një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur kanë patur një ndikim negativ në flukset e cmuara të ardhshme të mjeteve monetare të aktivitetit financiar dhe kjo mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Evidenca objektive që aktivet financiare të zhvlerësohen mund të përfshijë mospagimin nga huamarrësi, ristrukturimin e kredisë ose paradhëniet nga Shoqëria me terma që Shoqëria nuk do t'i kishte konsideruar në një rast tjetër, të dhëna që një huamarrës do të falimentojë, ose të dhëna të tjera të vëzhgueshme që lidhen me një grup aktivesh të tilla si ndryshimet negative në statusin e pagesave të huamarrësit ndaj Shoqërisë, kushte ekonomike që lidhen me dështimin e pagesave ndaj Shoqërisë ose zhdukja e një tregu aktiv.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktiviteti financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar.

Aktivitetet financiare të cilat janë të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në baza individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare vlerësohet bashkarisht në grupe që mbartin karakteristika të ngjashme risku. Për trajtimin e zhvlerësimit kolektiv Shoqëria përdor modelimin statistikor të trendeve historike të probabilitetit të mospagimit, kohës së rikuperimit dhe vlerën e humbjes së ndodhur, përshtatur me gjykimin e drejtimit nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditit janë të tilla që humbjet aktuale të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimet historike.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Një humbje zhvlerësimi mund të anulohet nëse ulja në zhvlerësim ka ndodhur për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi. Anullimi njihet në fitim ose humbje.

(ii) Aktive jo-financiare

Vlera e mbartur e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përvec inventarëve dhe aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në fund të cdo periudhe raportuese për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ekzistojnë tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbartur e aktivitetit ose e njësisë gjeneruese të aktiveve monetare tejkalon atë të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

Një njësi gjeneruese e aktiveve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm që gjeneron flukse monetare gjerësisht të pavarura nga grupet apo aktivet e tjera. Vlera e rikuperueshme e një aktiviteti apo e një njësie gjeneruese të aktiveve monetare është me e madhja ndërmjet vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë të tij pasi janë zbritur shpenzimet e shitjes. Për të vlerësuar vlerën në përdorim, flukset e pritshme të parasë skontohen deri në vlerën aktuale të tyre duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton kushtet e vlerësuara të tregut dhe vlerën në kohë të parasë si dhe risqet specifike që lidhen me këtë aktivitet.

Përsa i përket aktiveve të tjera, një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka tregues që kjo humbje nuk ekziston më dhe ka pasur ndryshime në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën në përdorim. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret deri në atë masë sa vlera e mbartur e aktivitetit nuk tejkalon vlerën e mbartur që do të ishte përcaktuar si vlerë neto pas zbritjes së amortizimit dhe nëse nuk do të ishte njohur humbje nga zhvlerësimi.

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(vlerat në Lek, përvecse kur është shprehur ndryshe)

3 Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(f) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shitja e mallrave gjatë rrjedhës së aktivitetit normal të biznesit maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose që është për t'u marrë, përjashtuar skontot tregtare dhe taksat mbi shitjet. Të ardhurat njihen kur rreziqet dhe përfitimet domethënëse të pronësisë i janë transferuar blerësit, është e mundur marrja e shumës së konsideruar, kostot shoqëruese dhe kthimet e mundshme të të mirave janë të vlerësueshme në mënyrë të besueshme, nuk ka përfshirje të vazhdueshme të manaxhimit me mallrat, dhe shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme.

E ardhura nga shërbimet e kryera njihet në fitim ose humbje në proporcion me fazën e realizimit të transaksionit në datën e raportimit.

Për të ardhurat nga qiraja operative e makinave referoju politikës 3(g).

Shoqëria ka detyrim ligjor për sa i përket garancive për makina të reja me të drejtën për të kërkuar nga prodhuesi ndonjë punë që i përket garancisë. Ajo njuh të njëjtën vlerë të të ardhurave nga garancia në momentin që kostot e garancisë ndodhin.

Garancitë e zgjatura përtej termave të prodhuesit njihen siç përshkruhet në politikën 3(i).

(g) Qeraja operative

Aktiviteti objekt i qerasë operative janë paraqitur në pasqyrat financiare sipas natyrës së aktivitetit. Të ardhurat nga qeraja janë njohur në fitim ose humbje në mënyrë lineare përgjatë periudhës së qeradhënies, për sa kohë që një model tjetër sistematik do të ishte më i përshtatshëm për trendin kohor në të cilin përdorimi ose përfitimi nga aktivi i dhënë me qera zvogëlohet. Kostot, përfshirë amortizimin që ndodh gjatë përfitimit të të ardhurave nga qeraja, njihen si shpenzime.

(h) Përfitimet e punonjësve

(i) *Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore*

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Qeveria Shqiptare është përgjegjëse për përcaktimin e limitit ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

(ii) *Pagesa për lejet vjetore*

Shoqëria njuh si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të vlerësuar në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhet në këmbim për shërbimin e punonjësve gjatë periudhës.

(i) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të shkuara, Shoqëria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe ka shumë të ngjarë që për të shlyer detyrimin, të kërkohej një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike. Provizionet janë përcaktuar duke skontuar flukset e pritshme monetare me një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe, sipas rastit, risqet specifike të detyrimit. Amortizimi i skontos njihet si kosto financiare.

Garancitë shtesë

Garancitë shtesë përfshijnë detyrime për garanci të premtuara në lidhje me shitjet e makinave të reja dhe të përdorura. Provizionet bazohen në të dhëna historike të garancive dhe përfshijnë cdo lloj parashikimi që shoqërohet me mundësitë përkatëse.

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(vlerat në Lek, përvecse kur është shprehur ndryshe)

3 Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(j) Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat nga fondet në banka. E ardhura nga interesi njihet kur ai përfitohet, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për kreditë e marra. Kostot e kredisë që nuk lidhen direkt me blerjen, ndërtimin apo prodhimin e një aktivi që kualifikohet për kapitalizimin e këtyre kostove, njihen direkt në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit prezantohen neto si e ardhur ose shpenzim financiar në varësi të lëvizjes në kursin e këmbimit nëse rezulton në një pozicion neto fitimi apo humbje.

(k) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi njihen në fitim ose humbje.

(l) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale dhe ai i shtyrë njihen në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose të ardhura të tjera përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet ose të arkëtohet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë është njohur për diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Tatimi i shtyrë është matur duke përdorur normën tatimore që pritet të aplikohet ndaj diferencave të përkohshme kur ato kthehen, bazuar në ligjet në fuqi ose që hyjnë në fuqi menjëherë në datën e raportimit.

Aktivitet dhe pasivitet tatimore të shtyra netohen nëse ekziston një e drejtë ligjore për të netuar detyrimet për tatimin aktual të pagueshëm ndaj tatimit të parapaguar, dhe ato lidhen me tatimin mbi të ardhurat që përcakton i njëjti autoritet tatimor.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për humbjet fiskale të papërdorura, kreditime tatimore dhe diferenca të përkohshme të zbritshme për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ato të mund të përdoren. Aktivitet tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe tatimit të shtyrë Shoqëria merr në konsideratë ndikimin e një pozicioni tatimor të paqartë dhe tatimet dhe interesat shtesë që mund të lindin. Shoqëria beson se përlllogaritja e detyrimeve tatimore është e saktë për të gjitha periudhat e tatueshme bazuar në vlerësimin e disa faktorëve, duke përfshirë interpretimin e legjislacionit tatimor dhe experiencën e mëparshme. Kjo përlllogaritje mbështetet në vlerësime dhe supozime si dhe mund të përshijë një sërë gjykimesh rreth ngjarjeve të ardhshme. Në rast se si rredhojë e disponimit të një informacioni, gjykimi i Shoqërsë për mjaftueshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese ndryshon, ky ndryshim do të reflektohet në shpenzimin tatimor të periudhës kur ai përcaktohet.

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(vlerat në Lek, përvecse kur është shprehur ndryshe)

3 Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(m) Standarde dhe interpretime të reja ende të pa-zbatuara

Një numër standartesh të reja, rishikime të standarteve dhe interpretime nuk janë ende efektive për periudhat vjetore që fillojnë pas 1 janar 2013, dhe nuk janë aplikuar herët në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Asnjë nga këto nuk pritet të ketë efekt të konsiderueshëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

4 Përcaktimi i vlerave të drejta

Disa politika kontabël të Shoqërisë dhe shënime shpjeguese kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë për akivet dhe detyrimet si financiare ashtu edhe jo-financiare. Vlerat e drejta janë përcaktuar për qëllime matje dhe/apo shpjeguese bazuar në metodat e mëposhtme. Aty ku është e aplikueshme, informacion i mëtejshëm rreth supozimeve të bëra në përcaktimin e vlerës së drejtë është përfshirë në shënimet përkatëse të atij aktivi apo detyrimi:

Aktivet financiare të mbajtura me kosto të amortizuar

Vlera e drejtë për llogaritë e arkëtueshme është vlerësuar me vlerën aktuale të flukseve të ardhshme monetare, skontuar me normën e tregut të interesit në datën e raportimit. Kjo vlerë e drejtë është përcaktuar për qëllime shënimi shpjegues.

Detyrimet financiare të mbajtura me kosto të amortizuar

